

LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MENAXHIM ME
PRONË TË KONFISKUAR, DOBI PRONËSORE DHE SENDE TË MARRA
NË PROCEDURË PENALE DHE KUNDËRVAJTËSE

Neni 1

Në Ligjin për menaxhim me pronë të konfiskuar, dobi pronësore dhe sende të marra në procedurë penale dhe kundërvajtëse ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/2008 dhe 145/10), në nenin 27 paragrafi 1 pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "ose Byroja për ekspertiza gjyqësore e Republikës së Maqedonisë".

Neni 2

Titulli i nenit 48 dhe neni 48 ndryshohen si vijojnë:

"Shitja dhe lëshimi i pronës së marrë përkohësisht

Neni 48

Prona e patundshme e marrë përkohësisht nuk mund të jetë lëndë e shitjes.

Agjencia me pëlqim të marrë paraprakisht të gjykatës ose organit që e ka miratuar vendimin për marrje të përkohshme do të miratojë vendim për shitje ose lëshim të pronës së tundshme të marrë përkohësisht, nëse vlerëson se me ruajtjen e pronës zvogëlohet vlera e saj ose shpenzimet për ruajtjen e saj janë joproportionalisht të mëdha. Agjencia kërkesën për pëlqim paraprak për shitje dhe lëshim e parashton te gjykata ose organi që ka miratuar vendim për marrje të përkohshme të pronës së tundshme në afat prej dhjetë ditësh nga dita e marrjes së njoftimit për pronën e tundshme të marrë përkohësisht.

Pëlqimin për shitje ose lëshim të pronës së tundshme të marrë përkohësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata ose organi do ta miratojë në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës nga Agjencia.

Agjencia pas marrjes së pëlqimit për shitje dhe lëshim të pronës së tundshme nga paragrafi 3 i këtij neni, siguron vlerësim të pronës së tundshme të marrë përkohësisht nga vlerësuesi i autorizuar ose Byroja për Ekspertiza Gjyqësore."

Neni 3

Titulli i nenit 49 dhe neni 49 ndryshohen si vijojnë:

"Pagesa e mjeteve nga shitja dhe lëshimi i sendeve të marra përkohësisht

Neni 49

Mjetet e marra nga shitja e sendeve të marra përkohësisht paguhen në llogari të veçantë të të hyrave të Agjencisë.

Nëse miratohet vendim i plotfuqishëm për kthim të sendit që është shitur, Agjencia pronarit ia paguan mjetet e marra nga shitja nga llogaria e veçantë e të hyrave të Agjencisë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Nëse miratohet vendim i plotfuqishëm për kthim të sendit të lëshuar të marrë përkohësisht në pajtim me nenin 48 paragrafi 2 të këtij ligji, Agjencia pronarit ia paguan mjetet në lartësi të përcaktuar me vlerësimin e kryer në pajtim me nenin 48 paragrafi 4 të këtij ligji."

Neni 4

Titulli i nenit 52 dhe neni 52 ndryshohen si vijojnë:

“Lëshimi i sendeve të marra
Neni 52

Agjencia mund t'u lëshojë sende të marra me vendim të plotfuqishëm organeve tjera shtetërore, fondeve, agjencive, drejtorive, institucioneve publike, trupave të pavarur rregullatorë të themeluar nga Republika e Maqedonisë, shoqërive tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe të tjerëve të themeluar nga Republika e Maqedonisë, si dhe njërive të vetëqeverisjes lokale, pas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Agjencia mund t'u lëshojë sende të marra përkohësisht për të cilat është marrë pëlqim sipas nenit 48 të këtij ligji organeve tjera shtetërore, fondeve, agjencive, drejtorive, institucioneve publike, trupave të pavarur rregullatorë të themeluar nga Republika e Maqedonisë, shoqërive tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe të tjerëve të themeluar nga Republika e Maqedonisë, si dhe njërive të vetëqeverisjes lokale, pas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.”

Neni 5

Pas nenit 52 shtohet titull i ri dhe nen i ri 52-a, si vijojnë:

“Sende të tundshme të marra në mënyrë të përhershme
Neni 52-a

Dispozitat e neneve 48, 49 dhe 52 të ligjit do të kenë të bëjnë edhe për sende të tundshme të marra në mënyrë të përhershme në pajtim me ligjin.“

Neni 6

Pas kapitullit VI shtohen dy kapituj të rinj VI-a dhe neni i ri 59-a dhe VI-b dhe dy nene të reja 59-b dhe 59-v, si vijojnë:

“VI-a MBIKËQYRJA

Neni 59-a

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror Administrativ.

VI-b DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 59-b

Gjobë në shumë prej 7 500 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës në organin, nëse vepron në kundërshtim me nenin 48 paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 6 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës në organin, nëse vepron në kundërshtim me nenin 48 paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet nëpunësit shtetëror ose personit zyrtar në organin, nëse vepron në kundërshtim me nenin 48 paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 59-v

Procedura kundërvajtëse do të udhëheqë dhe sanksione kundërvajtëse do të kumtojë gjykata kompetente.”

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.